FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 69	2002	Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GjK nr. 212 , datë 29.10.2002	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me nenin 7 të ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit"…….	1923
Vendim i GjK nr. 221, datë 4.11.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr. 991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.……..…….	1929
Vendim i GjK nr. 222, datë 4.11.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 66, datë 12.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Elbasan; nr. 72, datë 29.6.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 233, datë 18.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.…….……	1930

	……	
Vendim i GJK nr. 226, datë 6.11.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1030, datë 14.2.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1612, datë 11.12.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. H-32, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë…… ……..	1932

V E N D I M
Nr. 212 , datë 29.10.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar	i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar	i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar	i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i “ “
Kujtim Puto	Anëtar	i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.9.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.183 Akti që i përket:

KëRKUES: KRYEMINISTRI I REPUBLIKëS Së SHQIPëRISë, përfaqësuar nga zoti Ylli Manjani, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me autorizim.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKëS Së SHQIPëRISë, në mungesë.
2. PRESIDENTI I REPUBLIKëS Së SHQIPëRISë, në mungesë
3. KONTROLLI I LARTë I SHTETIT, përfaqësuar nga zoti Muhamed Kavaja, këshilltar juridik, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 14 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me nenin 7 të ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë e ligjit të mësipërm me Kushtetutën:

- Neni 14 i ndryshuar i ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” kufizon ndjeshëm pushtetin diskrecionar të Kuvendit dhe të Presidentit përsa i përket shkarkimit të kryetarit të atij institucioni.
- Nëse Kushtetuta do të lejonte kufizimin e rasteve të këtij shkarkimi do t’i përcaktonte vetë ato, ashtu siç e ka shprehur për organet e tjera kushtetuese.
- Gjykatës Kushtetuese nuk mund t’i jepen me ligj kompetenca që nuk janë parashikuar në Kushtetutë.

Subjekti i interesuar, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka parashtruar:

- Kryeministri i Republikës së Shqipërisë nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me Kushtetutën. Këtë mund ta bëjë Presidenti ose Kuvendi.
- Çështja nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, sepse kanë kaluar më shumë se 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e ligjit.
- Kufizimet e rasteve të shkarkimit në ligj bazohen në nenin 165/2 të Kushtetutës, në të cilën thuhet se Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
- Përderisa Kushtetuta ka përcaktuar afatin 7 (shtatë)-vjeçar të kohëzgjatjes së mandatit, pa u shprehur për kushtet e shkarkimit, këto kushte mund t’i caktojë ligji organik.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka kërkuar fillimisht shfuqizimin e nenit 14 të ligjit

nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me nenin 7 të ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000, me këtë përmbajtje:

“Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbaron para afatit kur:

a) jep dorëheqjen;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj rresht;

ç) deklarohet i paaftë mendërisht për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) ngarkohet me një detyrë të papajtueshme me funksionin e tij.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Me propozimin e Presidentit të Republikës, Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.”.

Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i Kryeministrit e kufizoi kërkesën në shfuqizimin e fjalisë së dytë e të tretë të paragrafit të tretë të këtij neni për njoftimin e Gjykatës Kushtetuese dhe për pëlqimin e kësaj të fundit për rastet e ndalimit apo arrestimit, si dhe në gjithë paragrafin e katërt për rastet e mënyrën e shkarkimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke shpallur parimet themelore të organizimit e të veprimtarisë së organeve kryesore të shtetit, ka përcaktuar edhe statusin e disa funksionarëve, duke bërë diferencime në varësi të funksioneve dhe kompetencave të çdo organi, si dhe të vendit që zënë në hierarkinë e organeve shtetërore. Kushtetuta veçon me një mbrojtje të veçantë Presidentin e Republikës, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, duke përcaktuar jo vetëm imunitetin nga ndjekja penale, por edhe rastet kur mandati i tyre mbaron para kohe apo shkarkohen nga detyra (nenet 90/2, 71/2, 128, 140).

Për drejtues të organeve të tjera shtetërore apo funksionarët e tyre si për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatin e Popullit e anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kushtetuta nuk ka parashikuar rastet e shkarkimit, dhe as rastet e mbarimit para kohe të mandatit. Ajo është mjaftuar duke u shprehur vetëm për imunitetin e tyre nga ndjekja penale, pa vënë kritere të posaçme përsa i përket palëvizshmërisë në detyrë. Megjithatë, Kushtetuta u ka krijuar këtyre organeve mundësitë e ushtrimit të funksioneve të tyre.

Mbrojtjen e pavarësisë në kryerjen e detyrave për disa organe kushtetuese, Kushtetuta e shikon tek nënshtrimi vetëm ndaj saj i ligjeve, ndërsa garancitë për palëvizshmërinë në detyrë si element të pavarësisë, Kushtetuta i sheh jo vetëm tek përcaktimi i rasteve për shkarkim dhe rasteve për mbarimin para kohe të mandatit, por edhe tek mjetet e tjera juridike e kushtetuese, siç janë: miratimi i ligjeve për organizimin e funksionimin e institucioneve me një shumicë të cilësuar prej 3/5 të deputetëve, përcaktimi i kuorumit të nevojshëm për nismën për shkarkim, si dhe kuorumit të nevojshëm për miratimin e shkarkimit të tyre.

Në rastin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar që për shkarkimin e tij është e mjaftueshme garancia që parashikon neni 162/2, pra investimi i dy organeve të larta të shtetit: Presidenti për të bërë propozimin dhe Kuvendi për të shqyrtuar e për të vendosur për këtë propozim. Pavarësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të kuptohet si pavarësi absolute pa lidhje e ndërvarësi nga organet e tjera. Ky organ, sipas nenit 161/1 të Kushtetutës, i nënshtrohet vetëm kësaj të fundit e ligjeve dhe ka kompetenca të kontrollit ekonomik e financiar në institucionet shtetërorë, e personat e tjerë juridikë shtetërore, në organet e pushtetit qendror e atij vendor. Për të kryer këto detyra, ai është i pavarur nga Këshilli i Ministrave, por, sipas nenit 164, i raporton Kuvendit jo vetëm për zbatimin e Buxhetit të Shtetit, por edhe për veprimtarinë e vet.

Mospërcaktimi në Kushtetutë i rasteve të shkarkimit apo të mbarimit para kohe të mandatit nuk do të thotë që në ligjet organike mund të përcaktohen vetëm rastet e shkarkimit që Kushtetuta ka caktuar për organe të tjera kushtetuese. Eshtë e vërtetë që neni 6 i Kushtetutës lejon shprehimisht që

organizimi dhe funksionimi i organeve kushtetuese të bëhet me ligjet e tyre organike, por në këto të fundit, ashtu si në çdo ligj tjetër, nuk mund të kufizohet vullneti i organeve që kanë prerogativën e shkarkimit të drejtuesve të organeve të tjera kushtetuese. Kushtetuta ka ndjekur kriterin se kur imuniteti nga ndjekja penale duhet shoqëruar edhe me garanci suplementare ose me klauzola specifike për funksionarin lidhur me qëndrimin e tij në detyrë, ajo e ka bërë këtë në mënyrë të shprehur. Jo vetëm kaq por, përderisa Kushtetuta ka trajtuar organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe statusin e drejtuesve të tyre, ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kufijtë e të drejtave të tyre. Për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla si "shkelja e Kushtetutës, kryerja e një krimi, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën etj.", atje ku nuk është shprehur. Si rrjedhojë, edhe në çështjen në shqyrtim ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke kufizuar rastet e shkarkimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit apo të mbarimit para kohe të mandatit pa u shprehur në Kushtetutë, ka kapërcyer caqet e kësaj të fundit.

Janë këto arsyet që Kushtetuta, për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka dashur të përcaktojë rastet e këtij shkarkimi; shkaqet e shkarkimit të tij i vlerësojnë Presidenti duke bërë propozimin dhe Kuvendi duke vendosur për këtë propozim.

Ndryshe nga sa pretendoi në gjykim, përfaqësuesi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në literaturën juridike dhe në jurisprudencën kushtetuese ka një ndarje të qartë midis konceptit të imunitetit dhe atij të palëvizshmërisë në detyrë. Imuniteti ka të bëjë me mbrojtjen e një kategorie të caktuar zyrtarësh (pra imuniteti ratione personae) nga juridiksioni i gjykatave penale dhe ka si element papërgjegjshmërinë për veprat penale, si dhe paprekshmërinë nga ndjekja penale. Palëvizshmëria në kuptimin kushtetues është element i garantimit të pavarësisë së organit, dhe jo i imunitetit. Ajo ka të bëjë me mbrojtjen nga shkarkimi nga detyra të zyrtarëve të lartë. Këtë qëndrim mban edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 165/2, e cila flet vetëm për imunitetin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe për këtë të referon tek norma kushtetuese për imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Vetë Kushtetuta imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e trajton në nenin 137/2, ndërsa shkarkimin e tij nga detyra e trajton më vete në nenin 140 të saj. Edhe përsa i përket imunitetit, Kushtetuta përcakton volumin e të drejtave duke bërë diferencime midis funksionarëve. Kështu, ndërsa Presidenti dhe deputetët gëzojnë si paprekshmërinë nga ndjekja penale, ashtu edhe papërgjegjshmërinë për këto vepra (me disa përjashtime), gjyqtarët, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokati i Popullit e anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gëzojnë vetëm paprekshmërinë nga ndjekja penale (me disa përjashtime të nenit 137/2 të Kushtetutës).

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka kërkuar gjithashtu shfuqizimin si antikushtetues të fjalisë së fundit të paragrafit të tretë të nenit 7 të ligjit që ka të bëjë me pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese për dërgimin në gjykatë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ndaluar ose të arrestuar. Kjo kërkesë nuk është e bazuar.

Imuniteti si koncept përfshin edhe mbrojtjen nga normat procedurale, prandaj paprekshmëria si element i imunitetit mbron funksionarin jo vetëm nga ndjekja penale, por edhe nga veprimet e nxituara procedurale që mund të kryejnë ndaj tij organet shtetërore. Shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese dhe dhënia e pëlqimit për arrestim nga kjo gjykatë brenda 24 orëve nga ndalimi ose arrestimi është pjesë e mbrojtjes procedurale të këtij funksionari. Vetë Kushtetuta në nenet 137/2 dhe 165/2 shprehet qartë për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për këtë problem dhe ligji organik i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka cituar atë që thotë Kushtetuta për imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Ligji nr.8599, datë 10.4.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", në nenin 7 ka kapërcyer caqet e Kushtetutës, edhe duke i dhënë kompetencë Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë vendimin e Kuvendit për shkarkimin e Kryetarit të këtij institucioni. Sipas nenit 124/2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe, përderisa një kompetencë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në të, nuk mund të ushtrohet prej kësaj Gjykate. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese rikonfirmon qëndrimin e mbajtur edhe në vendimin e saj nr. 34, datë 24.09.1996, sipas të cilit kompetencat e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndryshohen, të ngushtohen ose të zgjerohen, përveçse me ligj kushtetues.

Nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se paragrafi i parë i nenit 14 të ndryshuar (mbarimi para kohe i mandatit) ka lidhje me paragrafin e katërt të tij, prandaj, në bazë të nenit 48 të ligjit nr.8574, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë", vendosi shqyrtimin dhe shfuqizimin e tyre, së bashku për papajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë se me rregullimet e bëra në nenin 14 të ligjit të sipërm janë kaluar caqet e Kushtetutës, shfuqizimi i tyre nuk krijon mangësi ligjore. Neni 14 i ndryshuar do të vazhdojë të zbatohet për rregullimet e tjera, të cilat mbeten të pacenuara.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar pretendoi gjithashtu se Kryeministri nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e këtij ligji, përderisa mund ta vënë në lëvizje Presidenti dhe deputetët, që janë të vetmit pjesëmarrës në procesin e emërimit e shkarkimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky pretendim vjen në kundërshtim me nenin 134 të Kushtetutës. Sipas përmbajtjes së këtij neni, Kryeministri, ashtu si Presidenti, 1/5 e deputetëve, etj., mund ta verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht nëse akti që ai kërkon të shfuqizohet ka apo jo lidhje me veprimtarinë e tij. Vetëm për disa subjekte si Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, partitë politike dhe organizatat e tjera, Kushtetuta ka vënë kufizimin se mund ta vënë në lëvizje vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

I pabazuar është edhe pretendimi tjetër se është parashkruar afati për të kërkuar shfuqizimin e normave juridike të parashikuara në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000. Eshtë e vërtetë që neni 50 i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë parashikon afatin 3 (tre)-vjeçar për të kërkuar papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën, por ligji bazë i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 8599, datë 10.4.2000 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". Neni 7 i këtij ligji të ri ka ndryshuar nenin 14 të ligjit të mëparshëm, duke bërë një rregullim të ri dhe për këtë rregullim duhet të shprehet Gjykata Kushtetuese pas kërkesës së paraqitur brenda afatit 3 (tre)-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a e 134/b të Kushtetutës, si dhe neneve 48, 49 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit të parë e të katërt të nenit 14 të ligjit nr. 8270, datë 13.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me nenin 7 të ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", që kanë këtë përmbajtje:

"Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbaron para afatit kur:

a) jep dorëheqjen;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj rresht;

ç) deklarohet i paaftë mendërisht për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) ngarkohet me një detyrë të papajtueshme me funksionin e tij.

Me propozimin e Presidentit të Republikës, Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra."

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e fjalisë së dytë e të tretë të paragrafit të tretë të këtij neni.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa për deklarimin antikushtetues dhe shfuqizimin e nenit 7 të ligjit nr. 8599, datë

10.4.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” duhej të rrëzohej për këto arsye:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është organ kushtetues i pavarur. Një konkluzion i tillë bazohet në përmbajtjen dhe frymën e neneve 162-165 të Kushtetutës. Në këto dispozita sanksionohet se ky organ i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Nga ana tjetër nga analiza e interpretimi i këtyre dispozitave del se Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk i përket asnjërit prej të tre pushteteve, duke iu referuar ndarjes së tyre, e për pasojë një pozicion i tillë është deri në një farë mase përcaktues për statusin e tij si organ i pavarur. Nuk mund të lihet jashtë konsideratave edhe fakti se mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është për një periudhë prej 7 (shtatë) vjetësh, ndryshe nga mandatet e organeve të tjera kushtetuese, për të cilat shumica aludon se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka varësi.

Në favor të tezës së pavarësisë së këtij organi është edhe analiza e funksioneve që ai kryen. Kështu, në bazë të shkronjës “a” të nenit 163 të Kushtetutës, Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë. Dispozita në fjalë nuk përjashton nga ky kontroll ndonjë subjekt, qoftë edhe ato subjekte kushtetuese që kanë kompetenca për emërimin e shkarkimin e kryetarit. Për pasojë, do ta konsideroja paradoks që Kontrolli i Lartë i Shtetit të kontrollonte, qoftë edhe vetëm veprimtarinë ekonomike të organeve nga të cilat ai duhej të varej nga pikëpamja funksionale, organizative apo financiare. Pikërisht këtë ka parasysh edhe Deklarata e Limës, miratuar nga Kongresi i IX-të i Intosait, në kapitullin e II-të, pika 1 e të cilës tërheq vemendjen se “Institucionet e larta të kontrollit mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjektet e kontrolluara dhe mbrohen nga influencat e jashtme.”.

2. Ashtu sikurse për organet e tjera kushtetuese, organizimi dhe funksionimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të rregullohet me ligj, përderisa Kushtetuta nuk parashikon ndryshe (neni 6 i Kushtetutës).

Gjykatës Kushtetuese, në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesës së Kryeministrit, i dilte si problem kyç sqarimi i faktit: nëse në ligjet organike të organeve kushtetuese mund të rregullohen marrëdhëniet që kanë të bëjnë me statusin e tyre, kur këto nuk janë trajtuar konkretisht e zgjidhur nga Kushtetuta.

Po t’i referohemi Kushtetutës sonë, del se në këtë drejtim subjektet kushtetuese mund t’i klasifikonim në tre grupe kryesore. Në grupin e parë hynë organet statusi i të cilave (qoftë edhe vetëm mënyra e shkarkimit) zgjidhet në vija të përgjithshme nga vetë Kushtetuta; në grupin e dytë, ku statusi gjendet vetëm në disa elemente të shkëputura dhe në grupin e tretë statusi shprehimisht kufizohet vetëm në caktimin e mandatit dhe në konkretizimin e organit që emëron apo shkarkon drejtuesin e tij (drejtimi monokratik). I tillë është rasti përsa i përket Kontrollit të Lartë të Shtetit e kryetarit të tij.

A mundet që për organet e grupit të dytë apo të tretë të parashikohen në ligjet e tyre organike elemente të tjerë të statusit tej atyre të parashikuara në Kushtetutë. Përgjigja do të ishte negative, nëse ky problem do të trajtohej e zgjidhej në mënyrë mekanike, duke ballafaquar germën e ligjit me germën e Kushtetutës. Pakica ka mendimin se përgjigja e kësaj pyetje mund dhe duhet të dalë nga fryma e Kushtetutës dhe nga interpretimi i dispozitave të saj. Kjo është detyra e Gjykatës Kushtetuese, e cila, edhe pse e vështirë, të çon në rezultate pozitive, diametralisht të kundërta me ato ç’ka rezulton nga krahasimet e karakterit formal, mekanik.

Ky interpretim të çon në radhë të parë (pika 1) tek përfundimi se Kontrolli i Lartë i Shtetit është subjekt kushtetues i pavarur. Prej këtej rrjedh konkluzioni i dytë dhe deçiziv për çështjen: palëvizshmëria është garanci për pavarësinë dhe kjo palëvizshmëri nuk mund të mos ketë si element, veç të tjerave, përcaktimin rigoroz të rasteve të ndërprerjes së mandatit. Kjo tezë e përgjithshme është pranuar nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimet e saj nr. 2/1996, 8/1994); nga Komisioni për Demokraci nëpërmjet Ligjit (i Venecias), i cili shprehet se “palëvizshmëria është garanci e pranuar botërisht për pavarësinë”. Për këtë lloj garancie flitet edhe në dokumentet ndërkombëtare që kanë përcaktuar standardet e organizimit e të funksionimit të organeve të larta të kontrollit (S.A.I.). Në Rezolutetën e Presidentëve të Organeve të Kontrollit Europian, që daton në 26 tetor 1999, në Rekomandimin nr.2 thuhet shprehimisht: “…duhet të sigurohen garancitë dhe instrumentet kryesore për të siguruar pavarësinë funksionale dhe organizative.”.

Rrjedhojë e këtyre arsyetimeve është: Kushtetuta në mënyrë taksative nuk ka parashikuar rrugët dhe formën e mbarimit të mandatit për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por pranimi prej saj i parimit të pavarësisë ka hapur rrugën që nëpërmjet ligjit që del në bazë e për zbatim të saj, të

konkretizohej kjo pavarësi nëpërmjet një sërë elementesh si pavarësia organizative, funksionale, politike e financiare. Në këtë kuadër, rëndësi të posaçme marrin garancitë për këtë pavarësi, siç janë paprekshmëria dhe palëvizshmëria, të cilat, duke buruar nga Kushtetuta, me të drejtë gjejnë konkretizim në ligjin organik. Nga palëvizshmëria burojnë një sërë rregullash, më kryesori nga të cilët është ai që ka të bëjë me përcaktimin në mënyrë taksative të rasteve të mbarimit të mandatit apo të shkarkimit nga detyra të një subjekti kushtetues, në rastin tonë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përfundimisht, pakica deklaron se neni 7 i ligjit të atakuar, i cili parashikon rastet e ndërprerjes së mandatit, si dhe rastet e shkarkimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën, por buron prej saj. Natyrisht, pakica mendon se duhet shfuqizuar vetëm ajo pjesë e dispozitës që cakton Gjykatën Kushtetuese si organ që deklaron shkarkimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

A N Ë T A R
A. Karamuço

V E N D I M
Nr. 221, datë 4.11.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	“ “
Gjergj Sauli	Anëtar i	“ “
Alfred Karamuço	Anëtar i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i	“ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 10.10.2002 dhe 14.10.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 199 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. XHAVIT BELIU, përfaqësuar nga avokate Liljana Ruli, me prokurë.

2. MUHAMER PAZARI, përfaqësuar nga avokat Riza Hicka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PETRIT KULLOLLI, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me deklarim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr. 991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19. 12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari, si përfaqësues të familjarëve të tyre në të njëjtin gjykim ndaj subjektit të interesuar Petrit Kullolli, me kërkesa të veçanta dhe me pretendime të ndryshme, por me objekt të njëjtë kanë, kërkuar përpara Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të sipërcituara.

Kërkuesi Xhavit Beliu parashtron këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e këtyre vendimeve:

Së pari, është shkelur parimi procedural që gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet, por pa i kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Gjykatat kanë vënë të padituri në pozitën procedurale të kundërpaditësit, pa ngritur kundërpadi.

Së dyti, Gjykata e Kasacionit ka udhëzuar kthimin e çështjes për rigjykim dhe zbatimin e dispozitave të Kodit Civil aktual për marrëdhënie në fushën e pronësisë të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi. Kodi Civil i vitit 1982 (që duhet zbatuar në këtë rast) nuk njihte fitimin e pronësisë me bashkim e përzierje.

Të gjitha pretendimet e tjera të kërkuesit lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave nga ana e

gjykatave.

Kërkuesi Muhamer Pazari ka parashtruar në kërkesën e tij se nuk është në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Nëna e tij Maire Pazari figuron si palë e paditur në këtë gjykim, ndërkohë që ajo vetë nuk ka marrë pjesë, dhe as ka autorizuar ndonjë përfaqësues. Në dosje figuron një prokurë për familjen "Beliu", në të cilën thuhet se Maire Pazari qenka përfaqësuar me prokurë nga Kadri Pazari. Kërkuesi pretendon se prokura në emër të Kadri Pazarit nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Pra, sipas kërkuesit, është zhvilluar një gjykim ku nëna e tyre figuron si palë ndërgjyqëse, ndërkohë që ata vihen në dijeni për këtë gjykim në vitin 2002.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, përbërja e Gjykatës Kushtetuese, për arsye objektive, nuk ishte e plotë dhe mendimet e gjyqtarëve u ndanë në një mënyrë të tillë që nuk arrihej të votohej për ta zgjidhur atë përfundimisht.

Në këto kushte, duke qenë se mënyra e votimit ishte e tillë që ndikoi në mosmarrjen e një vendimi përfundimtar, si dhe duke qenë se ekziston mundësia që në të ardhmen me plotësimin e numrit të nevojshëm të vendimmarrjes së Gjykatës kjo çështje mund të rishqyrtohet përsëri, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "f" dhe 132 të Kushtetutës, si dhe në nenin 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I :

- Refuzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 222, datë 4.11.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 7.10.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 184 Akti që i përket:

KËRKUES: AGIM ÇERMA, përfaqësuar nga avokat Fariz Xhurxhi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 66, datë 12.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Elbasan; nr. 72, datë 29.6.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 233, datë 18.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e sipërcituara të gjykatave janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor dhe për shfuqizimin e tyre si antikushtetues ka parashtruar këto shkaqe kryesore:

Së pari, midis kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë ka patur papajtueshmëri interesash. Avokati ka realizuar mbrojtjen njëkohësisht për të pesë të pandehurit. Mbrojtësi del në mbrojtje të Gazmend Çermës (i pranishëm në gjykim), për të cilin kërkon pafajësi dhe në disfavor të kërkuesit Agim Çerma, që kërkon të deklarohet fajtor.

Së dyti, avokati mbrojtës ka tejkaluar tagret e përfaqësimit në këtë proces. Ai nuk ka patur tagre nga i gjykuari Agim Çerma për të pranuar fajësinë e tij, në kuptim të neneve 6 e 50 të Kodit të Procedurës Penale. Pohimi i fajësisë është e drejtë ekskluzive e të pandehurit dhe jo e mbrojtësit.

Për të gjitha veprimet e kryera nga mbrojtësi, kërkuesi pretendon se është shkelur e drejta e tij e mbrojtjes dhe është cenuar procesi ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Elbasan ka deklaruar kërkuesin fajtor në mungesë për veprën penale të parashikuar nga nenet 76 e 25 të Kodit Penal vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, përsa i përket kualifikimit ligjor të veprës, në nenin 78 të Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për kërkuesin dhe është ndryshuar për të gjykuarit e tjerë.

Nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, duke i analizuar ato me të dhënat që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe me ndikimin e drejtpërdrejtë që ato kanë sjellë në përfundimin e gjykimit, Gjykata Kushtetuese bindet se procesi gjyqësor është cenuar në thelbin e tij. Kërkuesit nuk i është garantuar mbrojtja në procesin gjyqësor. Është shkelur e drejta për t'u mbrojtur me avokat, sepse avokati nuk ka përmbushur në përputhje me ligjin detyrimet e tij ndaj klientit, të cilin kishte marrë përsipër për ta mbrojtur.

Mbrojtësi në këtë proces gjyqësor ka përfaqësuar njëkohësisht pesë të pandehur të akuzuar për veprën penale të vrasjes, në një kohë që midis të pandehurve rezulton e vërtetuar dhe e pohuar nga vetë gjykata në vendimin e saj që të ketë patur papajtueshmëri interesash. Neni 54 i Kodit të Procedurës Penale nuk lejon në kushte të tilla realizimin e mbrojtjes ligjore në procesin penal, duke vendosur për të shmangur shkeljen e konstatuar detyrim jo vetëm për mbrojtësin, por edhe për vetë organin procedues.

Mbrojtësi, përpara gjykatës së shkallës së parë, por edhe në të gjithë shkallët e tjera të gjykimit, ka kërkuar deklarimin fajtor për kërkuesin dhe pafajësinë për të pandehurin tjetër. Edhe në mbrojtjen e paraqitur me shkrim përpara gjykatës së shkallës së parë rezulton se avokati është mbështetur kryesisht mbi atribuimet e të pandehurit tjetër, për të cilin ai ka kërkuar pafajësinë. Njëkohësisht, mbrojtësi në këtë proces gjyqësor ka tejkaluar tagret e tij të përfaqësimit, sepse ka pranuar fajësinë e të gjykuarit Agim Çerma, ndërkohë që sipas nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale, kjo është një e drejtë që i rezervohet personalisht të pandehurit.

Nga shqyrtimi i të dhënave që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se avokati mbrojtës pranon përpara gjykatave për klientin e tij, i cili gjykohej në mungesë se "…këto pohime të të pandehurit Agim Çerma gjejnë vërtetim të plotë me shpjegimet që dha përpara gjykatës i pandehuri Gazmend…", se "…rezulton e provuar…", se ai "…ka konsumuar plotësisht elementet e veprës penale të vrasjes…", se i pandehuri "…është penduar thellë për veprat penale që ka kryer…" etj.

Veprime të tilla të kryera nga avokati, që prekin të drejtën e të gjykuarit për t'u mbrojtur, janë lejuar nga të gjitha gjykatat që e kanë shqyrtuar këtë çështje. Detyrë e organit procedues, sipas rregullave të përgjithshme procedurale që lidhen me gjykimin, është që t'i krijojë të gjitha mundësitë të akuzuarit për t'u përfaqësuar në mënyrë të efektshme dhe njëkohësisht të sigurohet që avokati të zbatojë detyrat e tij, përndryshe ai duhet të zëvendësohet.

Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në një proces gjyqësor, avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur avokati vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij në mbrojtje të të drejtave të klientit, ai shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat.

Nisur nga qëndrimet e mbajtura nga avokati mbrojtës, të cilat nuk mund t'i përkasin funksionit të mbrojtjes në një proces penal, si dhe duke pasur parasysh se pohime të tilla janë mbajtur parasysh edhe nga gjykata në arsyetimin e vendimit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesit Agim Çerma nuk i është krijuar mundësia për një mbrojtje të ligjshme në procesin gjyqësor, duke iu shkelur në këtë mënyrë e drejta për një mbrojtje të përshtatshme e të efektshme, e cila përbën një cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, si dhe të jurisprudencës kushtetuese në këtë drejtim.

Shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i vendimeve gjyqësore si të papajtueshme me Kushtetutën si rrjedhojë e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe dërgimi për shqyrtimin nga fillimi të kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë nuk prek afatet e paraburgimit dhe të shqyrtimit të çështjes, pasi sipas kërkesave të nenit 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" e të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, prishja e vendimeve nga një gjykatë më e lartë i lë ato pa fuqi juridike dhe bën që të fillojnë përsëri afatet e parashikuara për çdo shkallë të procedimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 66, datë 12.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 72, datë 29.6.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 233, datë 18.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 226, datë 6.11.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

Kristofor Peçi, Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 14.10.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.206 Akti që i përket:

KëRKUES:HYSEN, GUGASH BALENA; QAMILE, HAXHIRE KONÇI; LUMTURI TUFINA; DYLFIQAR TUFINA (HOXHA) E LEJLA DEMNERI, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari, me prokurë.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:

1. AGRON ISLAMAJ, përfaqësuar nga avokatët Petro Shapo e Bashkim Merkaj, me deklarim.

2. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE TIRANË, në mungesë

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 1030, datë 14.2.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1612, datë 11.12.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. H-32, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sipas kërkuesit, këto vendime janë rezultat i procesit të parregullt ligjor për këto shkaqe:

- Gjykatat nuk kanë bërë verifikimin e legjitimimit të palëve (neni 176 i Kodit Civil). Nuk është verifikuar ligjërisht se cili është paditësi Agron Islamaj, i cili padinë e ka ngritur për llogari të Qamil Manes, duke pretenduar se shtëpia është blerë dhe investimet janë bërë nga ky i fundit.

- Baza ligjore e padisë është neni 92/a i Kodit Civil, i cili u referohet veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme që nuk prodhojnë efekte juridike. Por, gjykata e apelit, duke pranuar bashkëpronësinë nuk e konsideron vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave absolutisht të pavlefshëm, por të vlefshëm, qoftë edhe pjesërisht. Kështu që vendimi i gjykatës së apelit mbetet pa ndonjë bazë ligjore të vlefshme.

- Gjykata e apelit ka marrë një vendim të ndërmjetëm për shtyrje të seancës për caktimin e një grupi ekspertësh. Ky plotësohet me një akt tjetër të nënshkruar vetëm nga kryesuesi i seancës, me të cilin caktohen ekspertët dhe u jepen detyrat. Kjo vjen në kundërshtim me nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët. Veç kësaj, caktimi i ekspertëve është bërë pa u marrë mendimi i palëve dhe pa qenë këta të pranishëm në kundërshtim me nenet 225, 226 e 227 të Kodit të Procedurës Civile.

Kryerja e këtyre veprimeve në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, ka shkelur parimin e paanësisë së gjykatës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesit Hysen Balena, etj. dhe subjekti i interesuar Agron Islamaj paraqiten si palë ndërgjyqëse në konfliktin civil me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, me të cilin kërkuesve u njihej e drejta e pronësisë mbi një shtëpi banimi. Ky konflikt është shqyrtuar në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor dhe në këtë mënyrë, në aspektin e shterimit të të gjithë mjeteve juridike të kërkuara nga neni 131/f i Kushtetutës, nuk përbën pengesë për kërkuesit që t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Pavarësisht nga zgjidhja në themel e çështjes nga gjykatat, e cila nuk paraqet ndonjë interes të veçantë për t’u përmendur në aspektin e kontrollit kushtetues, në kuadrin e pretendimeve të kërkuesve për proces të parregullt ligjor dhe për të sqaruar bazueshmërinë e këtyre pretendimeve, sidomos për ekspertimin që përbën edhe një provë të rëndësishme për çështjen, është e nevojshme të vihen në dukje disa momente të procesit të gjykimit.

Në gjykimin e shkallës së dytë, gjykata e apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar dy akte ekspertimi me konkluzione të ndryshme dhe se pa argumente bindëse ka marrë për bazë vetëm njërin nga aktet. Në këto kushte, gjykata e apelit në seancën e datës 4.12.1996, me vendim

të ndërmjetëm, në prani të palëve, ka vendosur shtyrjen e seancës dhe kryerjen e një ekspertimi të ri me grup ekspertësh. Në bazë të këtij vendimi të ndërmjetëm, është përpiluar një vendim tjetër ku shënohen emrat e ekspertëve dhe detyrat që u shtrohen atyre për zgjidhje. Ky vendim, ndonëse paraqitet si i marrë nga trupi gjykues, është nënshkruar vetëm nga kryetari i seancës, ashtu siç pretendohet edhe nga kërkuesit. Në seancën e fundit të datës 14.2.1997 shqyrtohet akti i ekspertimit në prani të palëve, ku sipas procesverbalit rezulton se avokati i kërkuesve ka parashtruar vërejtjet dhe pretendimet për konkluzionet e aktit.

Pretendimi i kërkuesve për proces të parregullt për mënyrën e caktimit të ekspertimit nga gjykata, nuk është i bazuar për këto arsye:

1. Thirrja e ekspertëve është vendosur nga gjykata në seancë me pjesëmarrjen e palëve, duke e konsideruar si një veprim të domosdoshëm dhe në përputhje me dispozitat procedurale. Fakti që ekspertët konkretë dhe detyrat që iu ngarkuan atyre u caktuan vetëm nga kryesuesi i seancës, ndonëse përbën shkelje të rregullave procedurale mbi mënyrën e caktimit të ekspertit, nuk e bën procesin të parregullt, përderisa në seancën pasardhëse trupi gjykues pranoi të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë aktin e tyre.

2. Në seancën gjyqësore kërkuesit janë përfaqësuar nga avokati i tyre, i cili, pasi është njohur me përmbajtjen e aktit të ekspertimit, ka bërë vërejtjet përkatëse. Në këtë mënyrë, palës nuk i është cenuar ndonjë e drejtë, siç pretendohet, sepse ajo e ka shprehur mendimin e saj. Mospranimi nga kërkuesit i rezultateve të aktit të ekspertimit nuk ka lidhje me mënyrën e caktimit dhe emrat e ekspertëve konkretë, por me vetë vlerësimin e përfundimeve të tij, gjë që është në kompetencë vetëm të gjykatës si organ i paanshëm.

3. Mbi ankimin e kërkuesve ndaj vendimit të gjykatës së apelit, çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke u dëgjuar edhe pretendimet e kërkuesve dhe në përfundim është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së apelit. Në këtë mënyrë, kolegji civil ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesve për proces të parregullt dhe ka vendosur sipas ligjit.

Në këto rrethana të zhvillimit të gjykimeve, Gjykata Kushtetuese çmon se shkeljet procedurale të lejuara gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe që parashtrohen në kërkesë për mënyrën e caktimit dhe vlerësimit të aktit të ekspertimit, nuk e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Me këtë rast, ajo thekson se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese për të investuar Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e tyre sa herë shfaqet prezenca e shkeljes së normave procedurale.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesve drejtuar Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk gjen pasqyrim në rekurset në Gjykatën e Lartë dhe që ka të bëjë me mosverifikimin e legjitimimit të palëve, rezulton se ai është i pabazuar. Sipas nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, padia ngrihet kur personi ka interes të ligjshëm në njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Në kundërshtim nga sa pretendohet në kërkesë, gjatë shqyrtimit gjyqësor është verifikuar dhe vërtetuar se subjekti i interesuar Agron Islamaj është i biri i Qamil Manes, i cili ka blerë ndërtesën në vitin 1960, prandaj ai legjitimohet në ngritjen e padisë.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuesve për mungesën e bazës ligjore të padisë meqenëse gjykata e apelit i njeh palët bashkëpronarë, është i pabazuar. Pavarësisht nga referimi në dispozitat konkrete të ligjit, padia e ngritur nga subjekti i interesuar ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zgjidhja e çështjes nga gjykata është në përputhje me ligjin.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se shkaqet e parashtruara në kërkesë nuk janë të tilla që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM I PAKICËS

Nuk pajtohemi me vendimin që u mor me shumicë votash, për këto arsye:

Ekspertiza e urdhëruar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila është marrë për bazë dhe ka shërbyer si provë vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile midis kërkuesve dhe subjektit të interesuar, nuk është kryer në përputhje me kërkesat e neneve 225 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Kështu, gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë plenare u vërtetua se në këtë drejtim gjykata e apelit ka lejuar këto shkelje procedurale:

Në kundërshtim me këto dispozita, ekspertët janë caktuar jo nga gjykata në trup gjykues, por nga relatori i çështjes, pa u marrë më parë mendimi i palëve për përbërjen e këtij grupi ekspertësh, pa i krijuar atyre mundësinë për të formuluar pyetjet që do t'u jepej përgjigje, pa i kërkuar ekspertëve të bënin betimin për kryerjen me nder të detyrës së ngarkuar.

Nga ana tjetër, në dosjen gjyqësore nuk ka dokumente që të vërtetojnë se kërkuesit janë njoftuar për ditën dhe orën që ekspertët do të shkonin në vend për të bërë këqyrjen e banesës objekt konflikti dhe për të bërë aty matjet e nevojshme. Është fakt se këto veprime janë kryer vetëm në praninë e subjektit të interesuar pa pjesëmarrjen e kërkuesve, të cilët mund të kishin vërejtje teknike për punën e ekspertëve gjatë këqyrjes dhe matjeve në objekt.

Edhe në në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese ata ndryshe nga sa pranon shumica, nuk kanë ngritur probleme që lidhen me vlerësimin e provave. Aktin e ekspertimit nuk e kontestojnë në përmbajtje, duke pretenduar për pasaktësinë e matjeve ose përllogaritjeve të gabuara të bëra nga ekspertët, por për parregullsinë e formimit të kësaj prove nga ana e gjykatës së apelit.

Kjo parregullsi siç u tha edhe më lart është evidente. Si e tillë, kjo ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme në shkeljen e së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, për vetë faktin se është e lidhur me një provë, e cila ka qenë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes.

Mosrespektimi i procedurës së parashikuar në ligj për marrjen dhe formimin e kësaj prove, i ka hequr mundësinë kërkuesve për të bërë prapësimet e nevojshme dhe për të realizuar kështu plotësisht të drejtën e tyre të mbrojtjes në këtë gjykim.

Për këto arsye, jemi të mendimit që edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk është rezultat i një procesi të rregullt ligjor. Përballë këtyre shkeljeve ai duhej të mbante tjetër qëndrim, dhe jo të ligjëronte si të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë. Shkelje të tilla janë evidente, gjejnë pasqyrim në dosjen gjyqësore dhe janë ngritur si probleme ligjore në rekursin që kanë ushtruar kërkuesit pranë këtij kolegji.

Në këto rrethana, mendojmë që Gjykata Kushtetuese duhej të pranonte kërkesën e tyre, duke shfuqizuar si antikushtetues të dy vendimet gjyqësore që përbëjnë objektin e saj.

Përsa i përket shkaqeve të tjera që kanë parashtruar kërkuesit lidhur me mungesën e legjitimimit të subjektit të interesuar në ngritjen e padisë, pajtohemi me qëndrimin e shumicës.

ANëTAR	ANëTAR
Z. Vuci	Gj. Sauli

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);

Kodi Penal	**Kodi i Procedurës Penale**	**Kodi i Procedurës Civile**	**Kodi Rrugor**
Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*	*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*
Mars, 2002	Shtator, 2002	Korrik, 2002	Qershor,2002

U dorëzua për shtyp më 7. 11. 2002
Doli nga shtypi më 8. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë